



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.964/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami kryetar i kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “FANS a.s. & Electronic Bussines PRO”, me seli ne Prishtinë dhe Çeki, te cilët i perfaqëson sipas autorizimit Halil Palaj avokat ne Prishtinë, lagja Upiana ndertesat “Beni Dona” ne Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.750/17 dt.29.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 12.10.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “FANS a.s. & Electronic Bussines PRO”, me seli ne Prishtinë dhe Çeki ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.750/17 dt.29.10.2020, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.750/17 dt.29.10.2020, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadija e paditësit “FANS a.s. & Electronic Bussines PRO”, me seli ne Prishtinë dhe Çeki, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit P.SH nr.38/17 të datës 24.03.2017 të Organit Shqyrtues të Prokurimit në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi, ne afat ligjor, ka parashtruar ankesë paditësi, për shkak të shkeljeve te dispozitave te procedurës administrative, vërtetimit të gabuar ë te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar te dispozitave materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj kete ankesë si te bazuar, aktgjykimin e atakuar ta ndryshoj, kerkespesadinë e paditesit ta aprovoj si te bazuar dhe aktvendimi PSH.nr.38/17 dt.21.03.2017 i OSHP te anuloj si i pabazuar.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Panelit Shqyrtues të Prokurimit Publik, PSH.nr.38/17 dt.21.03.2017, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, është hedhur poshtë si e palejuar ankesa e OE “FANS a.s. & Electronic Bussines PRO”, me seli në Prishtinë dhe Çeki, lidhur me aktivitetin e Prokurimit me titull “Modernizimi i fushave në Kullen ftohëse Blloku A4” me nr. Prokurimi KEKO-16/114/511, të iniciuar nga autoriteti kontraktues –AK-Korporata Energjetike e Kosoves (KEK), pasi i njëjti nuk ka arritur të deshmojë interes juridik-matrimonial konform nenit 111 par.1 pika 1.5 dhe 1.8 të LPP lidhur me nenin 4.1.26 të LPP, për shkak se i njëjti ka ofruar ofertë të papergjegjshme teknikisht sipas kriterëve të FDT. Në pikën II ka vërtetuar vendimin e AK-Korporata Energjetike e Kosoves KEK, Njoftimi për dhënien e kontratës dt.16.01.2017 i publikuar në Web-site të KRPP, lidhur me aktivitetin e prokurimit KEKO-16/114/511 dhe autorizon Autoritetin Kontraktues që të vazhdojë me këto aktivitete të prokurimit. Në pikën III, meqë ankesa e Operatorit Ekonomik ankues “FANS a.s. & Electronic Bussines PRO”, hedhet poshtë si e palejuar, konform nenit 118 të LPP-së, i kthehet sigurimi i ankesës.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 26.04.2017 me pretendim se vendimi i të paditurës është i kundërligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi dhe provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar sepse nga faktet e administruara në këtë kontest administrativ u vërtetua se e paditura ka vepruar në pajtim me dispozitat e LPP respektivisht nenin 111 par.1 pika 1.5 dhe 1.8 e lidhur me nenin 4 par.1 nenpar.1.26 të LPP, për shkak se paditësi kishte oferte të papergjegjshme teknikisht sipas kriterëve të përcaktuara me FDT, dhe kjo pasi edhe kjo gjykatë bëri krahasimin e ofertës së OE ankues dhe OE fitues sa i përket plotësimit të ofrimit të referencave në pajtim me kërkesën e dosjes së tenderit ku vërtetohet se paditësi në ofertimin e tij s’i ka bashkangjitur referencat e kërkuara në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit, kurse referencat e leshuara nga SLOVNAFT.AS CLEN SKUPINY MOL e realizuar me datën 02.08.2012 e bashkangjitur nuk ishte për tre vite e kaluara siç ishte kërkuar, prandaj meqë OE ankues s’i ka plotësuar specifikat teknike të detyrueshme si në përshkrimin e dosjes së tenderit (Aneksi1) nga këto arsye edhe kjo gjykatë e ka pranuar arsyetimin e të paditurës si i bazuar dhe në pajtim me nenin 1, 7, 59.2, 59.4, 4, 4.1.26 dhe nenin 111 të LPP. Vlerëson se e paditura me rastin e vlerësimit të ankesës së paditësit dhe operatoreve tjerë ka respektuar dispozitat e LPP. Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit se është shpërblyer OE i papergjegjshëm përkundër rekomandimit të ekspertëve shqyrtues, është vërtetuar një gjendje faktike e paligjshme si dhe janë aplikuar në mënyrë të gabuar dispozitat e se drejtës materiale duke vendosur çmim me të shtrenjtë, por këto pretendime si të tilla nuk u aprovuan meqë OE ankues tani paditësi nuk kishte ofruar referenca sipas kërkesës së FDT dhe plotësuar

specifikat teknike te detyrueshme te dosjes e tenderit per aktivitetin e prokurimit publik AK-KEK-16/114/511. Gjykata analizoi edhe pretendimet tjera te paditësit por te njëjtat si ka pa me ndikim ne vendosje tjetër nga çka ka vendosur i padituri me rastin e shqyrtimit te ankesës pas caktimit te marrjes se mendimit edhe te ekspertit, prandaj vlereson se ne kete çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga i padituri dhe drejtë janë zbatuar dispozitat e ligjit per Proceduren Administrative.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 99 të Ligjit për Prokurimin Publik i cili përcakton se “OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas pjesës IX të këtij ligji dhe kanë autoritetin dhe përgjegjësitë e parashikuara në atë pjesë”. Gjykata nuk e gjenë të themeltë pretendimin e paditësit se vendimi i kontestuar me padi është marr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit 04/L-042 për Prokurimin Publik pasi është pikërisht në bazë të nenit 105 paragrafi 2.8 që OSHP ka të drejtë ligjore që të anuloj ose revokoj vendimin e autoritetit të tillë lidhur me-ose të marrë gjatë aktivitetit te prokurimit, përfshirë kushtet e paligjshme ose specifikat në dosjen e tenderit.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje te dispozitave procedurale administrative, ky pretendim nuk qëndron, sepse meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, ka vlerësuar ekspertizen e ekspertit shqyrtues dhe teknik, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit se gjykata e shkallës së parë ka vepruar gabimisht kur veprimet e palës se paditur i merr si te drejta perkitazi referencave te OE ankues dhe atij fitues, kete pretendim kjo gjykatë e vlereson si te pabazuar sepse bazuar ne dosjen e tenderit përkatësisht ne piken 9.2 Deshmia e kërkuar dokumentare, nen piken 1 Autoriteti Kontraktues kërkon “Se paku 2 referenca ne realizimin e projekteve te ngjashme te modernizimet e kullave ftohëse ne termoelektranat e ngarkesave te përafërta (150 deri 250MW) te përfunduara ne tre vitet e fundit”, ndërsa OE ankues ne kete rast paditësi njëërën nga referencat e ka te datës 02.08.2012, per te cilën vet paditësi ne fjalën e tij ne seancën e datës 20.03.2017 para Organit Shqyrtues te Prokurimit konstaton se referenca eshte e vitit 2014 dhe është bërë gabim teknik nga lëshuesi i referencës, e qe për gjykatën nuk eshte relevant nje arsyetim i tillë për nje vendosje ndryshe sepse me asnjë provë nuk mund te argumentohet ky fakt pasi nuk ka dhen prova se kur ka pefudnuar ky aktivitet për te cilin është lëshuar kjo referencë, e kjo me qellim te vërtetimit te asaj çka arsyeton i njëjti dhe me qellim te vërtetimit te faktit se me te vertete kjo referencë ka te bëjë me kete periudhë per te cilën flet paditësi, pastaj i njëjti deklaroi se referenca e dytë është modernizim, e vertetë qe nuk e ka kapacitetin mirëpo është per modernizim, gjë qe për gjykatën e shkallës së dytë edhe ky

është një arsyetim i paqendrueshëm por një konfirmim i paditësit se referenca e ofruar nuk plotëson kushtet e kërkuara me Dosje te Tenderit. Poashtu Gjykata e shkallës së dytë përkitazi kësaj çështje vlerëson edhe raportin e ekspertizës të datës 13.03.2017 dhe konstatimeve të bëra në atë raport nga ekspertët shqyrtues dhe teknik.

Sa i përket pretendimit të paditësit në lidhje me validitetin e ofertave dhe vonësive në vlerësim të ofertave, gjykata e shkallës së dytë vlerëson mendimin e eksperteve shqyrtues dhe teknik, të dhënë në raportin e ekspertizës së datës 13.03.2017 të cilët ndër tjera konstatojnë se ka vonesa por ka vazhdim të validitetit dhe se në rastin konkret OE ankues dhe ai i rekomanduar për kontratë kanë vazhduar validitetin, nga rezulton se meqë edhe OE ankues-paditësi ka bërë vazhdimin edhe vet dhe se në seancën e shqyrtimit kryesor para OSHP në deklaratimet e tij askund nuk ka argumentuar se në lidhje me këtë ka pasur vërejtje apo ankesë, atëherë kolegji i kësaj gjykate bazuar në këto arsye vlerëson se një pretendim i tillë nuk qëndron dhe të njëjtin nuk e aprovon dhe se vonesat e tilla nuk kanë ndikuar në vendimin final të AK në rekomandim për dhënie të kontratës. Gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Fakti se paditësi nuk i ka plotësuar kushtet e parapara respektivisht specifikat teknike të kërkuara me dosjen e tenderit, edhe gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjendja faktike nuk ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative pranë të paditurës, ndërsa në bazë të fakteve të vërtetuara sa i përket pretendimit të paditësit se gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar veprim të kundërligjshëm të paditurit, se është shpërblyer me kontratë kompania e cila ka kërkuar shumën me të lartë dhe atë 1,369,414.60 euro duke tejkaluar çmimin substancial për kryerje të punëve prej 800,000.00 euro, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në shkresat e lëndës gjendet një kërkesë për zotimeve shtesë të mjeteve dhe autorizim, nga –Divizioni TC “A”-AZ:03/2017 në emër të Kostos së prituri total për shumën prej 3,357,191.82 euro, e aprovuar nga Menaxhmenti i AK me datën 13.04.2017, për projektin “Modernizimi i fushave në kullën ftohëse Blloku A4”. Andaj, për këtë arsye gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se vendimi i të paditurës me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit dhe është autorizuar Autoriteti Kontraktues që të vazhdojë me tutje me procedurën e prokurimit është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe se me këtë vendim paditësit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë ligjore.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimit dhe gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, sepse e njëjta ka arsyetuar se paditësi nuk ka ofruar ofertë të përgjegjshme teknikisht sipas kriterëve të percaktuara me FDT dhe njëra nga referencat e ofruara nuk ka të bëjë me periudhën për tre vitet e fundit të projekteve të kryera të ngjashme. Andaj marrë parasysh vendimin final të paditurit dhe të lartcekurat edhe kjo gjykatë vlerëson nën 4 të LIGJIT Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN

PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS I cili ne par.1.26 parasheh qe “*Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar*”, gje qe paditësi nuk mund te konsiderohet palë me interes ne rastin konkret, nga del se e drejta materiale nga gjykata e shkalles se parë është aplikuar drejtë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e vendosjes, pasi që me pretendimet ankimore të Paditesit, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr. 964/22, me datë 12.10.2023

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami